

**VENDIM**  
**Nr. 503, datë 30.5.2013**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, BRENDA PROGRAMEVE TË MIRATUARA PËR  
MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS, NË BUXHETIN E VITIT 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 16 e 17 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Rishpërndarjen e fondeve, ndërmjet programeve të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në buxhetin e vitit 2013, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 09770 “Për kërkim fundamental dhe ekselencë”, zëri “Shpenzime korente”, të zbritet fondi prej 25 700 000 (njëzet e pesë milionë e shtatëqind mijë) lekësh.

b) Në programin buxhetor 09450 “Arsimi i lartë”, zëri “Shpenzime korente”, të shtohet fondi prej 25 700 000 (njëzet e pesë milionë e shtatëqind mijë) lekësh.

c) Në programin buxhetor 09240 “Arsimi profesional”, zëri “Shpenzime kapitale”, të zbritet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh.

ç) Në programin buxhetor 09230 “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”, zëri “Shpenzime kapitale”, të zbritet fondi prej 29 000 000 (njëzet e nëntë milionë) lekësh.

d) Në programin buxhetor 09120 “Arsimi bazë”, zëri “Shpenzime kapitale”, të shtohet fondi prej 49 000 000 (dyzet e nëntë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**